

V E N D I M
Nr.473, datë 14.10.1999

PËR ADMINISTRIMIN DHE DHËNIEN ME QIRA TË DRUFRUTORËVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr.8333, datë 23.4.1998 “Për një ndryshim në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 “Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe privatizimit”, të ligjit nr.7776, datë 22.12.1993 “Për buxhetin lokal” dhe të ligjit nr.7929, datë 11.5.1995 “Për mbrojtjen e drufrutorëve”, me propozimin e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit dhe Ministrisë së Pushtetit Lokal, Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Pasuria shtetërore (drufrutore) e ish-ndërmarrjeve bujqësore, e cila ka mbetur pas shpërndarjes së tokave bujqësore, i jepet në administrim organeve të pushtetit lokal (komunave përkatëse).

2. Drufrutorët, pasuri shtetërore e ish-ndërmarrjeve bujqësore, të cilët ndodhen në sipërfaqet e tokave bujqësore, që janë vënë në dispozicion të Komitetit të Zhvillimit të Turizmit, u jepen në administrim komunave përkatëse.

3. Organet e pushtetit lokal (komunat), pas marrjes në dorëzim të pasurisë shtetërore nga drejtoritë e bujqësisë dhe ushqimit të rretheve përkatëse, e japin atë me qira. Vlera e qirasë vjetore është 5 për qind e çmimit të shitjes së drufrutorëve, (sipas udhëzimit të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit nr.1, datë 8.6.1998 në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.192, datë 2.4.1998 “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore që privatizohet dhe procedurat e shitjes”). Vlera e qirasë arkëtohet në favor të organeve të pushtetit lokal, të cilat përballojnë shpenzimet për administrimin dhe qiradhënien e pasurisë shtetërore.

4. Ministria e Bujqësisë dhe Ushqimit, Ministria e Pushtetit Lokal dhe Komiteti i Zhvillimit të Turizmit ngarkohen të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko